



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**  
**THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA**  
**SKUPSTINA OPSTINE-SUVA REKA**



---

**Projekt-RR E G U L L O R E**  
**PËR**  
**MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË**  
**TERRITORIN E KOMUNËS SË SUHAREKËS**

Suharekë-2026

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e konform nenit 8, pika (a), nenit 15 pika (f) dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 05/L-108, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016”, e në mbështetje të nenit 15 dhe nenit 34, të Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 29/2022”, dhe dispozitat nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në zbatim të kërkesës për rishqyrtimin e aktit të lëshuar nga Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor Nr. 1799-2/26 të datës 27.04.2026, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më -----, miratoi këtë:

**RR E G U L L O R E**  
**PËR**  
**MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË**  
**SUHAREKËS**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunal dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të natyrës së ngjashme me ato të amvisërisë, lartësinë e tarifës së taksës për menaxhimin e mbeturinave nga amvisëritë, mbeturinat komerciale apo industriale dhe mbeturinat institucionale me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar, ruajtjes së natyrës, ambientit jetësor dhe interesat tjera të përgjithshëm.

1.2 Aplikimi dhe shtrirja në funksion të sistemit për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave në pjesët urbane dhe rurale në gjithë territorin e Komunës së Suharekës, që nënkupton rregullat për grumbullimin, bartjen dhe vendosjen e mbeturinave për deponimi përfundimtar.

1.3 Më këtë rregullore po ashtu përcaktohet sistemi, orari dhe kushtet për mënyrën e grumbullimit të mbeturinave, vendosjen e kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen ato dhe mënyra transportit të tyre.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

2.1 Kjo rregullore definon minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e riciklimit dhe tarifë për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor të shëndetshëm në juridiksionin e Komunës së Suharekës.

2.2 Dispozita e kësaj Rregullore janë obligative për të gjitha bizneset, kompanitë publike përgjegjëse për mbeturinat dhe operatorët tjerë, si dhe të gjithë atyre që kanë të bëjnë me mbeturina brenda territorit të Komunës së Suharekës.

## Neni 3 Përkufizimet

- 3.1 **Mbeturina**- nënkupton substancë, apo objekt që prodhuesi ose zotëruesi e hedh ka për qëllim ta hedhë, apo është i detyruar ta hedhë.
- 3.2 **Menaxhim i mbeturinave**-nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;
- 3.3 **Operator**-nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
- 3.4 **Leje përkatëse mjedisore**-nënkupton Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
- 3.5 **Person**-nënkupton Personin fizik ose juridik, i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
- 3.6 **Ripërdorim**-nënkupton çfarë do operimi, me të cilin çdo produkt apo komponentë që nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar
- 3.7 **Mbledhje**-nënkupton mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 3.8 **Mbledhje e ndare**-nënkupton mbledhjen e mbeturinave kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik
- 3.9 **Prodhuesi i mbeturinës**-nënkupton secilin person veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë, ose çdo njëri që merret me paraprocesim përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
- 3.10 **Zotëruesi i mbeturinës**-nënkupton prodhuesin e mbeturinës apo personin që e zotëron mbeturinën.
- 3.11 **Mbeturina komunale**-nënkupton:
- 3.11.1. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjte, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobilet;
- 3.11.2. mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturina shtëpiake.
- 3.11.3. mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.
- 3.12 **Mbeturina e parrezikshme**-nënkupton mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
- 3.13 **Mbeturina komerciale**-nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen

mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi

3.14 **Mbeturina inerte**-nënkupton mbeturinat që nuk kanë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik në vendet ku janë deponuar si:

3.14.1 mbeturinat inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet e tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

3.14.2 i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

3.15 **Mbeturinë e vëllimshme**-nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportin dhe largim të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

3.16 **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qofte i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substance, përfshirë edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjate prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij.

3.18 **Qendra grumbulluese**-nënkupton lokacionin për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

3.19 **Deponi** – vend i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

3.20 **Konsumator**- personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas ligjit.

3.21 **Leje përkatëse mjedisore** – nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

3.22 **3R**-reduktim, ripërdorim dhe riciklim.

## Neni 4

### Llojit e mbeturinave

4.1 Llojet e mbeturinave të cilat i menaxhon Komuna në bazë të kësaj rregulloreje janë si në vijim:

4.1.1 Mbeturina komunale janë mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë në kuadër të cilat hyn.

4.1.2 Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

4.1.3 Mbeturina të vëllimshme - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe mbylljet.

4.1.4 Mbeturina nga konstruktimi-demolimet dhe mbeturinat tjera të gjeneruara nga aktivitetet ndërtimore;

4.1.5 Bio-mbeturinë janë mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat të ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit;

4.2 Mbeturina komerciale janë mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale.

4.3 Mbeturina industriale janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimi artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

4.4 Mbeturina medicinale janë mbeturina patologjike të cilat krijohen nga aktiviteti medicinal, si dhe materialet e tjera që përdoren në shërbimet mjekësore;

4.5 Mbeturinat shtazore janë mbeturina që krijohen nga amvisëritë, thertoret, mishtoret dhe aktivitetet e tjera të ngjashme.

## **Neni 5 Përrjashtimet**

5.1 Nga kjo rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:

5.1.1 mbeturinat e rrezikshme dhe

5.1.2 llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme

5.2 Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të akteve nënligjore të miratuar nga organi kompetent.

## **Neni 6 Përgjegjësia e Komunës për Menaxhimin e Mbeturinave**

6.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.

6.2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.

6.3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

6.4. Autorizimi i operatorit që të bëjë mbledhjen e mbeturinave dhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë, sipas nevojës

6.5 Të themelon në kuadër të Drejtorisë të Shërbimeve Publike të Suharekës, Sektorin e menaxhimit të mbeturinave, i cili monitoron dhe ofron udhëzime për ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave, menaxhon me bazën e të dhënave të gjeneruesve të mbeturinave shtëpiake dhe vepron sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.

6.6 Të bëjë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave.

6.7 Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.

6.8 Promovimi për minimizimin e mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.)

6.9 Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik- pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta.

6.10 Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.

6.11 Përpilimi i raporteve, mbi menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të tarifës mbi mbeturinat.

6.12 Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të taksapaguesve për mbeturina.

6.13 Propozon përcaktimin e tarifës dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare për menaxhimin e mbeturinave, për miratim në Kuvendin e Komunës.

6.14 Dorëzimi i Raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, për MMN çdo 31 mars të vitit pasues.

6.15 Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat.

6.16 Trajtimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshme brenda territorit të komunës

6.17 Hartimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM);

6.18 Të krijoj bazën e të dhënave me shënime për amvisëritë, bizneset dhe institucionet publike dhe private që pranojnë shërbime komunale të grumbullimit të mbeturinave, të cilat shënime (apo regjistra) përmbajnë të dhënat për përdoruesit e shërbimeve, të dhënat personale, adresën si dhe të dhënat e tjera të nevojshme. Këto të dhëna duhet të përditësohen rregullisht nga ana e komunës, përkatësisht nga Sektori mbi menaxhimin e mbeturinave -Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

6.19 Grumbullimin e mbeturinave të vëllimshëm komuna do ta bëjë së paku dy herë në vit, pa pagesë, sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.

6.19.1 java e parë e muajt maj (aksioni pranveror) dhe

6.19.2 java parë e muajt nëntor (aksioni vjeshtor)

## **Neni 7**

### **Sistemi i menaxhimit të mbeturinave komunale**

7.1. Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, transportohen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina edhe me Ligjin Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina dhe me këtë Rregullore.

7.2. Komuna ofron sistemin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave përmes operatorëve të licencuar publik, privat apo publiko-privat.

7.3. Mbeturinat grumbullohen nga amvisëritë, institucionet, bizneset, hotelet, restaurantet dhe hapësirat publike, grumbullimi i këtyre mbeturinave do të ofrohet në shërbimin:

7.3.1. sistemi i grumbullimit derë më derë dhe

7.3.2 në pikat grumbulluese me kontejner-hapësira publike.

7.4. Komuna përmes Sektorit të menaxhimit për mbeturina përkatës, bën përzgjedhjen dhe caktimin e vendeve, pikave grumbulluese të mbeturinave, caktimin e hapësirave për ndërtim të qendrave të mëdha për grumbullim. Pikat grumbulluese caktohen sipas Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave.

7.5. Menaxhimi i mirë i mbeturinave nënkupton: mbulueshmëri me shërbim në tërë hapësirën komunale, shërbim të rregullt dhe cilësor. Standardet cilësore të menaxhimit të mbeturinave përcaktohen në Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM).

7.6. Ngritja e vetëdijesimit publik që ka për objektive ngritjen e vetëdijes shoqërore për menaxhimin e mbeturinave, puna me komunitet, palët e interesit, të gjitha institucionet edukativo-arsimore të cilat funksionojnë në territorin e komunës, duhet të edukojnë të gjithë qytetarët në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse të trajtimit të mbeturinave.

## **Neni 8**

### **Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave**

Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

### **8.1 Konsumatorët e amvisërive:**

8.1.1 të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët dhe

8.1.2 të shërbyer sipas shërbimit derë më derë

### **8.2 Konsumatorët komercialë/industrialë:**

8.2.1 dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyese

8.2.2 subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të ulëta të shërbimit

8.2.3 subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit

### **8.3 Konsumatorët Institucional:**

8.3.1 konsumatorët e vegjël institucionalë

8.3.2 konsumatorë e mesëm dhe të mëdhenj institucionalë

8.3.2 konsumatorët e mëdhenj institucionalë, të shërbyer me kontratë

8.4 Përshkrimi i detajuar i mëtejshëm i këtyre kategorive dhe taksave gjendet në shtojcën

A si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

## **Neni 9**

### **Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave**

9.1. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave,

9.2. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në bazën e të dhënave në Sektorin e menaxhimit të mbeturinave-Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe të lidhin kontratën për shërbimin të gjeneruesit për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.

9.3. Gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar që të paraqesin ndryshimet e të dhënave përmes kërkesës zyrtare (si p.sh adresën, shitjen e pronës, trashëgimia, dëshmi dhe dokumente të përditësuara etj), në bazën e të dhënave tek Sektori i menaxhimit të mbeturinave-Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

9.4. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar.

9.5. Çdo gjenerues i mbeturinave të ngurta duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit komunal të menaxhimit të mbeturinave.

9.6. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes 3R, kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme)

9.7. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj tarifën e shërbimit.

9.8. Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

9.9. Ndërmarrjet prodhuese, të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës së Suharekës t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

9.10. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre ti hedhin në vende të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave ndërsa mbeturinat e rrezikshme, ti ndajnë dhe ti dorëzojnë në pikatë mbledhëse apo në vendet e caktuara nga Komuna.

9.11 Shërbimet e veçanta (largimi i mbeturinave të vëllimshme dhe mbeturinave të tjera që nuk largohen gjatë shërbimit të rregullt) bëhet me pagesë, për veç shërbimeve sipas nenit 6 pika 19.

9.12 Bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari të ndryshme janë të obliguar që ta mbajnë të pastër hapësirën para objektit dhe për rreth tyre.

## **Neni 10**

## **Baza e të dhënave dhe regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale**

10.1 Komuna e Suharekës-Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë-Sektor i menaxhimit të mbeturinave dhe kompania rajonale e mbeturinave “Eko-Regjioni” njësi punuese në Suharekë, do të krijoj bazën e të dhënave për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave komunale në territorin e kësaj komune, duke e respektuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-082-Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 5 paragrafi 1.5.

10.2 Baza e të dhënave do të regjistroj të dhënat personale të gjeneruesve, përcaktimin e llojit të mbeturinave nga gjeneruesit, kategorizimin e gjeneruesve, shumë e faturimit të tarifës dhe shumë e inkasimit të tarifës për grumbullimin e mbeturinave, me qëllim të interesit publik për implementimin e planit për menaxhimin efikas të mbeturinave komunale.

10.3 Përgjegjësi e menaxhimit, përditësimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave i takon Komunës së Suharekës-Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë-Sektor i menaxhimit të mbeturinave dhe kompanisë rajonale të mbeturinave “Eko-Regjioni” njësi punuese në Suharekë.

10.4 Regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale, bëhet me paraqitjen e këtyre dokumenteve:

10.4.1 dokumentin identifikues (letërnjoftimi, pasaporta)

10.4.2 dokumentet e regjistrimit për personat juridik (certifikata e biznesit ose akt themelimi etj.)

10.4.3 dëshmi- njehsorin e rrymës elektrike;

10.4.4 dëshmi mbi regjistrimin e objektit në tatimin në pronë;

10.4.5 dëshmi e pagesës së faturës për mbeturina në adresën ku ka banuar më parë (në rastet kur gjeneruesi e ndërron adresën e banimit)

10.4.6 dëshmi të certifikatës familjare (për kategorizim të faturës së tarifës në individë/familje)

10.4.7 në rastet e shitblerjes së objekteve, shitësi dhe blerësi duhet të kenë të paguar borxhin paraprak për mbeturinat në tërësi dhe të paraqesin kontratën e shitblerjes, për të i bërë ndryshimet në data bazë dhe në faturim.

10.5. Gjeneruesit të cilët posedojnë dy apo më shumë fatura të tarifës për mbeturina, për objekte banimi aktive, duhet të lajmërohen para organit komunal, respektivisht SMM për kategorizimin e ngarkesës së faturës.

10.6 Sipas paragrafit 4, të këtij neni, kategorizimi në ngarkesë të faturës nënkupton:

10.6.1 kategoria e parë: amvisëritë rezidenciale (vendbanimi i përhershëm);

10.6.2 kategoria dytë: amvisëritë jo rezidenciale (amvisëritë me vendbanim të përkohshme që jetojnë jashtë territorit të Komunës së Suharekës, të dëshmuar me kartelën vjetore të harxhimeve të energjisë elektrike

10.6.3 kategoria e tretë: amvisëritë pasive (shtëpi apo objektet e banimit të cilat janë të pabanuara por që pranojnë faturë për mbeturina) duhet të dëshmojnë me kartelën vjetore të harxhimeve të energjisë elektrike;

10.6.4 kategoria katërt: amvisëritë të tjera që nuk përfshihen kategoritë më të larta;

10.7 Në rastet e dyfishimit të faturave për të njëjtin gjenerues, anulohet/fshihen faturat nga baza e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave nëse ofrojnë dëshmi të mjaftueshme.

10.8 Çdo amvisëri që banon me qira është e obliguar të bëjë pagesën për mbeturina në emrin e vetë dhe duhet të regjistrohet në bazën e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave, ose të dëshmojë kontratën e nënshkruar qiradhënës dhe qiramarrës për banim.

## **Përcaktimi i tarifës për grumbullimin e mbeturinave komunale**

11.1. Tarifa për mbeturinat komunale për amvisëri apo individë, komerciale apo industriale dhe institucionale, faturohen dhe inkasohen nga kompania rajonale e mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë, faturimi i tarifës së mbeturinave bëhet në bazë mujore, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave, më së largu deri me datën 10, të muajit pasues dhe pagesa nga gjeneruesi bëhet direkt kompanisë rajonale të mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë.

11.2. Në përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të amvisërisë duhet të merren parasysh këto elemente ndikuese:

11.2.1 Shpenzimet operative të grumbullimit të mbeturinave (transporti, mirëmbajtja e mjeteve transportuese, burimet njerëzore etj)

11.2.2 Tarifa e pranimit nga deponia e mbeturinave.

11.2.3 Elementet tjera të ndikueshme nga aspekti ekonomik dhe ndikuesit tjerë për menaxhimin sa me efikas të mbeturinave.

11.3. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e tarifës së mbeturinave për çdo muaj të vitit si dhe në këste, nga 3 mujore brenda vitit, si më poshtë:

11.3.1 Kësti parë Janar - Mars

11.3.2 Kësti i dytë Prill - Qershor

11.3.3 Kësti i tretë Korrik- Shtator

11.3.4 Kësti i katërt Tetor-Dhjetor

11.4 Pagesa e tarifës për mbeturina bëhet në institucionet financiare për pagesa, në llogarinë bankare përkatëse të kompanisë rajonale të mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë.

11.5 Çdo person fizik apo juridik i cili për një periudhë të caktuar kohore nuk ka nevojë të marr shërbim të grumbullimit të mbeturinave, duhet të njoftoj paraprakisht me kërkesë sektorin për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Suharekës si dhe kompanisë rajonale të mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë dhe duhet të bashkëngjis këto dokumente:

11.5.1 dëshmi faturën mbi shpenzimin e rrymë;

11.5.2 dëshmi faturën mbi shpenzimin e ujit;

11.6 Një pronë mund të konsiderohet e pashfrytëzuar nëse për një periudhë prej 3 muaj nuk ka shpenzuar rrym më shumë se 40kw në muaj si dhe shpenzime të ujit jo më shumë se 1m<sup>3</sup> në muaj.

11.7 Lirimi nga pagesa do të bëhet në mënyrë retroaktive, pas paraqitjes së kërkesës me dokumentet e kërkuar në pikën 12.5 të këtij neni.

### **Neni 12**

#### **Tarifa mbi mbeturinat komunale të amvisërisë**

12.1 Fatura e tarifës komunale për mbeturinat komunale i lëshohet çdo kryefamiljari, individi dhe personave fizik dhe juridik.

12.2 Tarifa komunale e mbeturinave shtëpiake ndahet në tre kategori, në:

12.2.1 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë/komunal/individë: 12, muaj

12.2.2 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë/komunal/familje: 12 muaj

12.2.3 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët jorezident/diaspora/familje: 12 muaj

12.4 Tarifa për mbeturinat komunale për konsumatorët komercial, industrial dhe institucionale kategorizohet dhe përcaktohet në shtojcën A të kësaj rregullore e cila është pjesë përbërës.

### **Neni 13**

## **Obligimi i pagesës së tarifës për mbeturinat**

13.1 Të gjithë gjeneruesit të cilët marrin shërbim mbi grumbullimin e mbeturinave dhe janë të regjistruar në bazën e të dhënave, detyrohen të paguaj tarifën. Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan 2, (dy) këste të njëpasnjëshme (janar-mars dhe prill-qershor), ndaj secilit gjenerues do të iniciohet procedure e përmbarrimit tek përmbarruesit privat për pagese të detyrueshme të borxhit.

13.2. Shkalla e tarifës do të rishikohet çdo dy vjet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë-Sektori i menaxhimit të mbeturinave, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit, etj.

13.3 Kur Kuvendi Komunal në Suharekë miraton shkallën e përshtatshme të propozuar për vitin në vijim, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal.

13.4 Tarifa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave tu ofrohet institucioneve dhe bizneseve të mëdha, të kontraktohen individualisht siç edhe është përcaktuar për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

### **Neni 14**

#### **Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për Shërbimin e Mbeturinave**

14.1 Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë i pajisur me leje dhe është i obliguar që të veproj sipas kontratës, ligjeve në fuqi dhe kësaj rregulloreje.

14.2 Operatori i kontraktuar është obliguar që të raportoj për çdo muaj për shërbimet kontraktuese si dhe ta dorëzoj raportin vjetor deri në fund të muajt shkurt të vitit kalendarik në sektorin për menaxhimin e mbeturinave (SMM).

### **Neni 15**

#### **Veprimet e ndaluara**

15.1 Në bazë të kësaj rregulloreje ndalohen veprimet si më poshtë;

15.1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;

15.1.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve të tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është parapare;

15.1.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat përbashkëta, brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkone, korridore, tarraca të banesave eti);

15.1.4 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të ricikluara;

15.1.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

15.1.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (ne rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike);

15.1.7 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;

15.1.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, apo në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;

15.1.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshë apo të ngjashme, nga kontejnerët ose pikat mbledhëse të mbeturinave;

15.1.10 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina komunale dhe komerciale";

- 15.1.11 Gërmimi, përzieja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e pa autorizuar.
- 15.1.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
- 15.1.13 Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
- 15.1.14 Personat e autorizuar për transportin e mbeturinave duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponin të mbeturinave;
- 15.1.15 Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.

## **Neni 16**

### **Dispozitat Ndëshkuese –Gjobat**

- 16.1 Ndaj gjeneruesit të mbeturinave, i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina do të iniciohet procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente ose me procedura përmes përmbaruesve privatë.
- 16.2 Çdo person fizik apo juridik i cili shkel dispozitat e neneve të kësaj Rregullore do të kryej kundërvajtje dhe do të ndëshkohet, sipas Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina.
- 16.3 Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, për veprimet e ndaluara sipas nenit 15, inspektori komunal, inspektori mjedisit dhe policia e Kosovës, shqipton gjobë mandatorë sipas, Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina.
- 16.4 Pala e pakënaqur kundër vendimit të inspektoratit, ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në pajtim me rregullat e Ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

## **DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 17**

#### **Mbikëqyrja**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje janë kompetente Kryetari i Komunës, Drejtoria Inspektoratit dhe Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë si dhe organet komunal përkatës, si dhe Policia e Kosovës.

### **Neni 18**

#### **Epërsia me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore**

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregullore dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 29/2022”, do të aplikohen dispozitat e ligjit dhe akteve tjera nënligjore, të cekura më lart, ndërsa dispozitat përkatëse të kësaj Rregullore konsiderohen të revokuara.

### **Neni 19**

## **Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin**

Kjo rregullore mundë të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, me propozimet e arsyetuare nga propozuesi.

### **Neni 20 Hyrja në fuqi**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

### **Neni 21 Zbatimi**

Kjo rregullore fillon të zbatohet-implementohet nga 01 korrik i vitit 2026 dhe e shfuqizon Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës, 01-Nr-110-18191 e datës 21.05.2020.

## **KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**

01-Nr- \_\_\_\_\_  
Me data \_\_\_\_\_

**Kryesuesi i Kuvendit**  
\_\_\_\_\_  
**Mr.ec Bexhet KUÇI**

## Ç M I M O R E

### LISTA E KONSUMATOREVE PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE (MUJORE) PËR VITIN 2026

**I. Kategoria amvisëri :** *Shërbimi derë-më derë dhe me kontejnerë të përbashkët*

<b>Tarifat mujore</b>	<b>Tarifa</b> 7.50 € / njësi familjare 4.50 € / individë
<b>Kategoritë</b>	Amvisëri jo rezident (diaspora) 3.00 € / njësi familjare për muaj

**II. KATEGORIA E KONSUMATOREVE KOMERCIAL / INDUSTRIAL:** *Shërbimi derë-më derë dhe me kontejnerë të përbashkët*

Zona e Parë	Zona e dytë	Zona e tretë
Suharekë	Sopijë	Stravuqin
Shirokë	Savrovë	Krushicë e ulët
Reshtan	Bukosh	Budakovë
	Vraniq	Krushicë e epërme
	Reqan	Mohlan
	Mushtisht	Doberdelan
	Dubravë	Nishor
	Sallagrazhd	Kasterc
	Grejkoc	Populan
	Gjinoc	Maqitevë
	Gelancë	Papaz
	Leshan	Vërshec
	Tërnje	Qadrak
	Nepërbisht	Grejqevc
	Samadrexhë	Luzhnicë
	Studenqan	Breshanc
	Peqan	Delloç
	Bukosh	Dvoran
	Bllacë	
	Duhël	
	Semetisht	
	Sllapuzhan	

Vërejtje: kontejneri 1.1 m<sup>3</sup> x 80.00 euro për një zbrazje është për mishtore dhe xhampresa.

I. Tarifa mujore	II. Tarifa mujore	III. Tarifa mujore	IV. Tarifa mujore	V. Tarifa mujore
Zona A: 9.00 € Zona B: 8.00 € Zona C: 6.00 €	Zona A: 10.00 € Zona B: 8.00 € Zona C: 6.00 €	Zona A: 13.00 € Zona B: 10.00 € Zona C: 9.00 €	Zona A: 16.00 € Zona B: 15.00 € Zona C: 10.00 €	Zona A: 30.00 € Zona B: 20.00 € Zona C: 15.00 €
Avokaturat Zyre tjera Agjencionet Bizhuteritë Argjendarit Optika Çajtoret Kozmetikët Këpucëtarët Ortarët Farkëtarët Kafe pjekësit Video lojërat Kurset e gjuhëve Kiosqet Fotografisë Auto parkingjet Auto larjet Rrobaqepëse Këmbimorët	Kompanitë sigurimeve Auto shkollat Frizerët Mobil shop Kompjuter shop Auto elektrikist Auto mekanik Auto veglat Barnatore bujqësore Auto pjesë Librarit Elektro material Vullkanizer Bastoret Hekurishtet Zdrukthëtarët Serëvis teknikes bardh Parkingjet	Butikët Barnatoret Dyqanet e këpucëve Sanitarit Laboratorët Minimarket Dyqanet Tekstil Sallonet e perdeve Sallone teknike bardh Pllacet ndërtimore	Kafiterit Ëmbëltoret Qebaptoret Byrektoret Gjellëtoret Piceritë Marketet Motelet Pompë benzinës (vetëm pompë) Sallonet e tepihëve Mobilierit Ordinancat Depot e pijeve Depot ushqimore	Restorantet Hotelet Furrat Pompa Benzinës –me objekt përcjellës
Çmimet sipas zbrazjeve				
Vëllimi i Kontinerit	1.1 m <sup>3</sup>	5.0 m <sup>3</sup>	7.0 m <sup>3</sup>	
Tarifa (Euro/zbrazje)	<b>15.00 €</b>	<b>57.00 €</b>	<b>67.00 €</b>	

<b>Tarifa mujore 10.00 €</b>	<b>Tarifa mujore 18.00 €</b>	<b>Tarifa mujore 35.00 €</b>	<b>Tarifat mujore 1 kontejnerë 1.1 m<sup>3</sup> (51.00 €)</b>
Zyre e partive Politike, Përfaqësitë të shoqatave, Objekte fetare	Teatër Galeri e arteve Biblioteka Çerdhe dhe te ngjashme	Bankat Mikro financat Institucionet Financiar Zyre postare Keds Kost Hidroregjioni Të ngjashme	Objektet Komunale QKMF-ja Poliklinikat specialistike Ambulancat Shkollat Gjykatat Posta Policia Qendra regjistrimit (QKRC) Stacioni autobusëve Salla sportive
Shërbimet e ofruara me kontejnerë të veçantë			
Vëllimi i kontejnerit	1.1 m <sup>3</sup>	5.0 m <sup>3</sup>	7.0 m <sup>3</sup>
Tarifa (euro/zbrazje)	<b>20.00 €</b>	<b>57.00 €</b>	<b>67.00 €</b>